



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8970 Prot.

Roskovec, më 08, 10 2022

V E N D I M

Nr. 74, datë 30/09/2022

" PËR MIRATIM FONDESH NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2022"

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.3 gërma c, neni 54 pika dh, të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjen vendore", neni 45, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar neni 44, të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", vendimit të Këshillit të Bashkisë, të VKB nr.103 datë 24.12.2021 "Për miratimin e buxhetit, numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartëse për vitin 2022" si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoritë përkatëse të Bashkisë; Këshilli i Bashkisë,

-VENDOSI:

- I. Marjen e dy ambjenteve me qera në pronësi të z. Pelivan Hatia Suk1 për tu përdorur për ambjente shkollore për nxënësit e shkollës "5 Dëshmorët" e cila do të rikonstruktohet.
Vlera për qeranë do të jetë 14,000 lekë në muaj për secilin objekt për një periudhë prej 8 muaj nga dita e lidhjes së kontratës.
Efektet financiare do të përballohen nga fondi i llogarisë 602 për arsimin bazë për vitet 2022-2023.
- II. Mbështetur në VKM Nr.682 datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit" i ndryshuar me VKM Nr.98 datë 09.02.2022, miratohet financimi nga Bashkia Roskovec të shpenzimeve për transportin e nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit në institucioneve arsimore publike të qytetit Roskovec dhe Fier por që nuk paguhet nga buxheti i shtetit, në masën 30% të vlerës së biletës në këto linja si më poshtë:
 - Fshati Luar-Roskovec, vlera e biletës 100 lekë
 - Fshati Velmish-Roskovec, vlera e biletës 70 lekë
 - Fshati Arapaj-Roskovec, vlera e biletës 70 lekë
 - Fshati Vlosh-Roskovec, vlera e biletës vajtje ose ardhje 80 lekë

Ky shpenzim do të përballohet nga zëri i shpenzimeve operative (llog.602) të miratuar në Buxhetin e Bashkisë Roskovec.

III.Bazuar në VKM nr.625,datë 28.09.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.165 datë 02.03.2016“ , të miratohet ndryshimi I nivelit të pagave të administratës së bashkisë dhe dy ndërmarjeve në vartësi sipas tabelës së bashkëlidhur këtij vendimi.

IV . Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Roskovec dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

V.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

